



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 136

18 tetor

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 593, datë 29.8.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 416, datë 11.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Elbasan të qarkut të Elbasanit”.....	7719
Vendim i KM nr. 629, datë 28.9.2012	Për emërim në detyrë.....	7719
Vendim i KM nr. 630, datë 26.9.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, për Qendrën e Studimeve Albanologjike për organizimin e konferencës ndërkombëtare “100 Vjet Pavarësi”.....	7720
Vendim i KM nr. 631, datë 26.9.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për mbulimin e shpenzimeve për sjelljen në Shqipëri të “Mesharit” të Gjon Buzukut, me rastin e 100-Vjetorit të Pavarësisë.....	7720
Vendim i KM nr. 635, datë 5.9.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 804, datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së personelit të Policisë së Shtetit”.....	7721
Vendim i KM nr. 636, datë 19.9.2012	Për një shtesë në vendimin nr. 760, datë 1.9.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë kombëtare të pronësisë intelektuale dhe industriale, 2010-2015”.....	7721

Vendim i KM nr. 637, datë 19.9.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 23, datë 20.1.2010 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare Bërthamore”, të ndryshuar.....	7722
Vendim i KM nr. 639, datë 19.9.2012	Për disa ndryshime në vendimin nr. 1301, datë 29.12.2009 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 400 kv Tiranë - Podgoricë në qarkun e Shkodrës”.....	7723
Vendim i KM nr. 640, datë 19.9.2012	Për dhënie ndihme financiare familjes së të ndjerit, Adem Haxhi Tahiraj, ish-punonjësi i Policisë së Shtetit, vvarë në krye të detyrës.....	7725
Vendim i KM nr. 665, datë 26.9.2012	Për miratimin e një ndryshimi në kontratën e koncesionit për menaxhimin, operimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin teknik të terminalit të kontejnerëve në portin e Durrësit, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Durrës Kurum Shipping” sh.a. dhe “Global Ports Holding” sh.a., miratuar me vendimin nr. 532, datë 13.7.2011 të Këshillit.....	7725
Vendim i KM nr. 673, datë 3.10.2012	Për miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Riviera” sh.p.k., “EHW” sh.p.k., “Energji Project” sh.p.k. & “Atlantik” sh.a., për ndërtimin e hidrocentraleve në rrjedhën e lumit të Matit.....	7726
Udhëzim i MPCSSH nr. 7, datë 20.9.2012	Mbi zbatimin e vendimit nr. 618, datë 7.9.2006 “Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, të ndryshuar.....	7726
Udhëzim i MPCSSH nr. 8, datë 20.9.2012	Mbi zbatimin e vendimit nr. 277, datë 18.6.1997 të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar.....	7727
Udhëzim i MPCSSH nr. 9, datë 16.10.2012	Mbi zbatimin e vendimit nr. 31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar.....	7727
Udhëzim i MPCSSH nr. 10, datë 1.10.2012	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 5, datë 1.8.2012 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror”.....	7728
Udhëzim i MBUMK nr. 9, datë 27.8.2012	Për kushtet e transportimit, magazinimit dhe mirëmbajtjes së plehrave që përdoren për bimësinë.....	7728
Udhëzim i MBUMK nr. 10, datë 13.9.2012	Për mënyrën e përllogaritjes së kriterëve të vlerësimit të ofertave për marrjen me qira të tokës bujqësore, të pandarë.....	7730

Udhëzim i MD dhe MSH nr. 2649/5, datë 4.7.2012	Për mbulimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve nga skema e sigurimeve shëndetësore, të detyrueshme.....	7731
Udhëzim i KMDHP nr. 21, datë 24.9.2012	Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e mëdhenj...	7732
Udhëzim i KMDHP nr. 22, datë 24.9.2012	Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e vegjël.....	7740
Vendim i KKRT nr. 124, datë 24.9.2012	Për dhënie licence për radion private vendore “Capital Radio”.	7742
Vendim i KKRT nr. 125, datë 24.9.2012	Për dhënie licence për radion private vendore “Radio Glob”....	7743
Vendim i KKRT nr. 126, datë 24.9.2012	Për dhënie licence subjektit person fizik Ardian Sulovari për televizionin privat kabllor “Tv kabllor DIRE”.....	7743
Vendim i KKRT nr. 127, datë 24.9.2012	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Antena Nord”.....	7744
Vendim i KKRT nr. 128, datë 24.9.2012	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Scan”.....	7744
Vendim i ERE nr. 134, datë 17.9.2012	Mbi kontratën për furnizimin me energji elektrike ndërmjet shoqërisë “KESH” sh.a. (furnizuesi publik me shumicë) dhe shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. (furnizuesit publik me pakicë) për periudhën 1.1.2012 deri më 31.12.2014.....	7745
Vendim i ERE nr. 135, datë 20.9.2012	Mbi ankimin administrativ të “CEZ Shpërndarje” sh.a. në lidhje me vendimin nr. 128, datë 11.9.2012 “Për procedimin administrativ për vendosje gjore ndaj shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a.” të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.....	7746

VENDIM
Nr. 593, datë 29.8.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 416, DATË 11.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË
PËRDORIM TË BASHKISË ELBASAN TË QARKUT TË ELBASANIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën bashkëlidhur vendimit nr. 416, datë 11.7.2007 të Këshillit të Ministrave, shtohen pronat me nr. 948 – 959 (nëntëqind e dyzet e tetë – nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë), gjithsej, 3 (tre) fletë, sipas lidhjes nr. 1 dhe formularëve, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
 2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Elbasan

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
948-959	Infrastrukturë (rrugë, lulishte, trotuare)	Në pronësi

VENDIM
Nr. 629, datë 28.9.2012

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Nard Ndoka emërohet Zëvendësministër i Brendshëm.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 630, datë 26.9.2012

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SHKENCËS, PËR QENDRËN E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE PËR ORGANIZIMIN E KONFERENCËS NDËRKOMBËTARE “100 VJET PAVARËSI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, t’i shtohet fondi prej 16 794 188 (gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e njëqind e tetëdhjetë e tetë) lekësh, për Qendrën e Studimeve Albanologjike për organizimin e Konferencës Ndërkombëtare “100 Vjet Pavarësi”.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 631, datë 26.9.2012

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE PËR SJELLJEN NË SHQIPËRI TË “MESHARIT” TË GJON BUZUKUT, ME RASTIN E 100-VJETORIT TË PAVARËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në artikullin 602, aparati “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 2 827 440 (dy milionë e tetëqind e njëzet e shtatë mijë e katërqind e dyzet) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve për sjelljen në Shqipëri të “Mesharit” të Gjon Buzukut, me rastin e 100-Vjetorit të Pavarësisë.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 635, datë 5.9.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 804, DATË 21.11.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PERSONELIT TË
POLICISË SË SHETIT”**

Në mbështetje të neneve 100 e 119 të Kushtetutës dhe të neneve 41, 86 e 129 të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në tekstin e rregullores së personelit të Policisë së Shtetit, miratuar me vendimin nr. 804, datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave, shkronja “d” e pikës 4 të nenit 66, shfuqizohet.

2. Ngarkohet Ministria e Brendshme për miratimin e strukturave të sistemit policor sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr. 636, datë 19.9.2012

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 760, DATË 1.9.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË PRONËSISË INTELEKTUALE DHE
INDUSTRIALE, 2010-2015”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në paragrafin e parë të kreut IV “Llogaridhënia dhe monitorimi”, të tekstit “Strategjia kombëtare e pronësisë intelektuale dhe industriale, 2010-2015”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 760, datë 1.9.2010 të Këshillit të Ministrave, pas fjalëve “... kryetari i Këshillit të Radios dhe Televizionit...” të shtohen “...si dhe inspektori i përgjithshëm i Inspektoratit Qendror...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha



VENDIM
Nr. 637, datë 19.9.2012

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 23, DATË 20.1.2010 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE
BËRTHAMORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të ligjit nr. 10 314, datë 16.9.2010 “Për ratifikimin e protokollit shtesë të marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike, për zbatimin e garancive në të gjitha veprimtaritë bërthamore të Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 23, datë 20.1.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të pikës 3 bëhen këto shtesa:

“ - inspekton dhe verifikon gjendjen dhe inventarin e raportuar nga përdoruesit dhe zotëruesit e lëndëve e të materialeve, të parashikuara në protokollin shtesë dhe në vetë marrëveshjen e garancive;

- harton raportet për materialet e sipërpërmendura dhe përdorimin paqësor të energjisë dhe teknologjisë bërthamore;

- informon në vazhdimësi Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (IAEA) për gjithçka dhe sa herë është parashikuar në protokollin shtesë të marrëveshjes së garancive.”.

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. AKOB-ja, për të realizuar misionin dhe objektivat e saj, si dhe për plotësimin e detyrimeve institucionale, që rrjedhin nga protokollin shtesë i marrëveshjes së garancive, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë ndërmjet institucioneve të ndryshme të vendit, publike dhe/ose private, të grupeve të interesit, vendase dhe/ose të huaja, dhe, konkretisht, me:

- Qendrën e Fizikës Bërthamore të Zbatuar;

- Komisionin e Mbrojtjes nga Rrezatimi;

- Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (IAEA);

- struktura të ngjashme të vendeve të ndryshme të rajonit dhe të botës;

- universitete dhe institucione kërkimore në fushat që mbulon dhe përfshin programi kombëtar bërthamor;

- institucione jofitimprurëse e donatorë të ndryshëm vendas dhe/ose të huaj, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

- institucionet, publike e private, përdoruese dhe zotëruese të lëndëve e materialeve, të parashikuara në protokollin shtesë dhe në vetë marrëveshjen e garancive.”.

3. Përdoruesit e zotëruesit e lëndëve e të materialeve, të parashikuara në protokollin shtesë dhe në vetë marrëveshjen e garancive, krijojnë kushtet dhe mundësitë për inspektim dhe verifikim, sa herë që të lindë nevoja.

4. Efektet financiare përballohen nga Agjencia Kombëtare Bërthamore.

5. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Agjencia Kombëtare Bërthamore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 639, datë 19.9.2012

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1301, DATË 29.12.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS
400 KV TIRANË - PODGORICË NË QARKUN E SHKODRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 1301, datë 29.12.2009 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqe të përgjithshme prej 9 460 (nëntë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) m², tokë bujqësore, shtëpi, arë dhe ullishte, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 78 497 611 (shtatëdhjetë e tetë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë) lekësh.”.

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Fondi prej 78 497 611 (shtatëdhjetë e tetë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë) lekësh të përballohet nga fondet e OST sh.a.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



SHTESA E LISTES SE PRONAREVE PER SHPRONESIM PER EFEKT TE NDERTIMIT TE LINJES SE T. L 400 KV TIRANE-PODGORICE QARKU SH

Qarku Shkopder

KOMUNA: Kastrot

N/r	OBJEKTI	Shpronësimi definitiv									
		Emri	Mbiemri	Lloji I pasurisë	Nr. Kadastra	Nr. pasurisë	Sasia e sip pronës m2	çmimi shtjje ZRPP	Vlera kompesimit	Adresa	Informacion
1	linja 400 KV	Paulin	Dekaj	shtëpi nen linje	1964	811	46	30679	1,411,234	Kastrat	me certifikate pronësie
2	linja 400 KV	Palok	Drekaj	shtëpi nen linje	1964	398	27	30679	828,333	Kastrat	me certifikate pronësie
Totali							73		2239567		

VENDIM
Nr. 640, datë 19.9.2012

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES TË TË NDJERIT, ADEM HAXHI TAHIRAJ,
ISH-PUNONJËS I POLICISË SË SHTETIT, VRARË NË KRYE TË DETYRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës financiare, prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh, për familjen e të ndjerit, Adem Haxhi Tahiraj, ish-punonjësi i Policisë së Shtetit, vrarë në krye të detyrës.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 665, datë 26.9.2012

**PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË KONTRATËN E KONCESIONIT PËR
MENAXHIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE PËRMIRËSIMIN TEKNIK TË
TERMINALIT TË KONTEJNERËVE NË PORTIN E DURRËSIT, TË LIDHUR NDËRMJET
MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT DHE BASHKIMIT TË
PËRKOSSHËM TË SHOQËRIVE “DURRËS KURUM SHIPPING” SHA DHE “GLOBAL
PORTS HOLDING” SHA, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 532, DATË 13.7.2011 TË
KËSHILLIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 128 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” dhe të neneve 15, 21, pika 4, e 27, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi në kontratën e koncesionit të lidhur ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, si autoritet kontraktues, dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Durrës Kurum Shipping” sh.a. dhe “Global Ports Holding” sh.a., për menaxhimin, operimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin teknik të terminalit të kontejnerëve në Portin e Durrësit, sipas tekstit dhe shtojcës 1, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 673, datë 3.10.2012

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT”, TË LIDHUR
NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE
BASHKIMIT TË PËRKOHSHËM TË SHOQËRIVE “RIVIERA” SHPK, “EHW” SHPK,
“ENERGJI PROJECT” SHPK & “ATLANTIK” SHA, PËR NDËRTIMIN E
HIDROCENTRALEVE NË RRJEDHËN E LUMIT TË MATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4, e 27, të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Riviera” sh.p.k., “EHW” sh.p.k., “Energji Project” sh.p.k., & “Atlantik” sh.a., për ndërtimin e hidrocentraleve në rrjedhën e lumit të Matit, sipas tekstit dhe anekseve që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr. 7, datë 20.9.2012

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 618, DATË 7.9.2006 “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
TË DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË PAGESËS PËR PERSONAT ME
AFTËSI TË KUFIZUAR”, TË NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, në zbatim të pikës 27 të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 7.9.2006, është 9 500 (nëntë mijë e pesëqind) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 1 të vendimit. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i personit me aftësi të kufizuar.

2. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 7.9.2006, është 9 500 (nëntë mijë e pesëqind) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2 të vendimit dhe 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj për kujdestari.

3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2012 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2012 për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në programin “Mbrojtja sociale”, tit. 10430, kap. 1, art.606.

4. Udhëzimi nr. 114, datë 4.8.2011 i Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet nga 1.9.2012.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera

UDHËZIM

Nr. 8, datë 20.9.2012

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 277, DATË 18.6.1997 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBRIT”, TË NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, në zbatim të pikës 16 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997 është 10 850 (dhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë në muaj. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i të verbrit.

2. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2012 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2012 për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në programin “Mbrojtja sociale”, tit. 10430, kap. 1, art.606.

3. Udhëzimi nr. 115, datë 4.8.2011 i Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet nga 1.9.2012.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera

UDHËZIM

Nr. 9, datë 16.10.2012

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 31, DATË 20.1.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT, PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK”,
TË NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, në zbatim të pikës 8 të vendimit nr. 31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë të përcaktuar në pikën 4 të vendimit nr. 31, datë 20.1.2001, është 9 500 (nëntë mijë e pesëqind) lekë në muaj.



2. Masa e përfitimit për kujdestarin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik të përcaktuar në pikën 4 të vendimit nr. 31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave, është 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.

3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2012 dhe përballohen me fondet e akorduara për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në programin “Mbrojtja sociale”, tit. 10430, kap. 1, art.606.

4. Udhëzimi nr. 113, datë 4.8.2011 i Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet nga 1.9.2012.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera

UDHËZIM
Nr. 10, datë 1.10.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 5, DATË 1.8.2012 “PËR NIVELIN E KUOTAVE
TË SHPENZIMEVE PËR USHQIME, NË INSTITUCIONET PUBLIKE REZIDENCIALE E
KOMUNITARE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR”**

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 24 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në pikën 1, germa “f” të udhëzimit nr. 5, datë 1.8.2012 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror”, të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në fund të paragrafit të parë, shtohet fjalia:

“Për klientët e grup-moshës 16 vjeç deri në moshën e daljes në pension, sipas kategorisë së përfituesve të përcaktuar në germën “e” të këtij udhëzimi.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe e shtrin efektin financiar nga 1.1.2013.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera

UDHËZIM
Nr. 9, datë 27.8.2012

**PËR KUSHTET E TRANSPORTIMIT, MAGAZINIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË PLEHRAVE
QË PËRDOREN PËR BIMËSINË**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 9 pika 2 të ligjit nr. 10 390, datë 3.3.2011 “Për plehtrat e përdorimit për bimësinë”,

UDHËZOJ:

I. KUSHTET E TRANSPORTIT

1. Kushtet për transportimin, magazinimin dhe mirëmbajtjen e plehrave të përdorimit për bimësinë janë si më poshtë:

a) Transportimi i plehrave në të gjitha rastet të bëhet i mbuluar me qëllim që ngarkesa të mbrohet nga reshjet, si dhe të parandalohen rrjedhjet që mund të ndodhin gjatë transportit.

b) Mjetet që transportojnë plehra të plotësojnë kërkesat teknike, si më poshtë:

i) ambienti i brendshëm i mjetit të jetë i pastër, i thatë dhe pa objekte që mund të dëmtojnë ambalazhin e produkteve, si gozhda apo pjesë të tjera metalike;

ii) mbulesa e mjetit të ketë mundësi që të hapet dhe të mos dëmtohet gjatë hapjes, si dhe të jetë e papërshkueshme nga uji dhe drita e diellit;

iii) kapakët anësorë të karrocërisë së makinës dhe mbulesa të kenë mbyllje shumë të mirë;

iv) të jetë pajisur me mjetet kundër zjarrit.

c) Transporti i plehrave të bëhet vetëm me ambalazhet e tyre origjinale. Kur gjatë transportit dëmtohet ambalazhi dhe plehu derdhet, mjeti duhet të ndalojë dhe drejtuesi i tij duhet të marrë masat për ndalimin e derdhjes së plehut dhe në rastet kur është derdhur, të merren masa për grumbullimin e tij, duke evituar të gjitha pasojat që mund të shkaktojë derdhja.

ç) Ndalohet transporti i plehrave me mjete që transportojnë:

i) njerëz ose kafshë;

ii) ushqime për njerëz dhe kafshë.

d) Mjetet e transportit të plehrave mund të përdoren për qëllime të tjera, vetëm pasi të jenë pastruar mirë dhe me kujdes, larg qendrave të banuara, burimeve, kanaleve të ujit, lumenjve dhe ujëmbledhësve.

e) Gjatë transportit, plehrat duhet të shoqërohen me dokumentet e origjinës së tyre.

ë) Në rastet kur plehrat transportohen të paketuara me peshë më të madhe se 25 kg, shkarkimi i tyre të bëhet me mjete që u rezistojnë këtyre ngarkesave.

II. KUSHTET E MAGAZINIMIT

1. Mjediset për magazinimin dhe tregtimin e plehrave duhet të jenë të miratuara nga Inspektorati Sanitar Shtetëror i rrethit ose qarkut.

2. Magazinat duhet të kenë:

a) mjetet e nevojshme për shuarjen e zjarrit;

b) materialet e ndihmës së shpejtë dhe mjetet mbrojtëse individuale;

c) mjediset hijeno-shëndetësore me ujë të rrjedhshëm;

d) mjediset të veçanta për qëndrimin e punonjësve.

3. Për ruajtjen e plehrave duhet të ngrihen magazinat të posaçme, larg qendrave të banuara, ujit të pijshëm, zonave ujëmbledhëse, puseve, rezervuarëve dhe lumenjve.

4. Magazinat të ngrihen në vende që nuk mbajnë ujë apo që kanë afër ujëra nëntokësore dhe dyshemeja të shtrohet me zhavorr të trashë me trashësi 30-40 cm, ku mbi të hidhet beton ose të shtrohet me dërrasë.

5. Për të penguar krijimin e degëzimeve të ujërave nëntokësore, muret e magazinës ose të ambientit ku ruhen plehrat, duhet të lyhen me bitum, në lartësi deri në 1 m. Në këtë mënyrë, përmirësohen kushtet e ruajtjes, ngurtësimi dhe lëngëzimi të plehrave, të cilat janë shumë të ndjeshëm ndaj lagështirës.

6. Njësitë e tregtimit me pakicë të plehrave duhet të ndërtohen ose të përshtaten, në mënyrë të tillë që të garantojnë ruajtjen e cilësive fiziko-kimike të tyre.

III. KUSHTET PËR MIRËMBAJTJE

1. Plehrat e të gjithë tipave nuk duhet të mbahen në ambient të jashtëm, në hangarë të hapur apo ambiente të pamiratuara.

2. Plehrat ndahen nga njëri-tjetri me ndarëse prej dërrase ose materiali tjetër izolues. Nga sipër plehrat në të gjitha rastet duhet të mbuloen me polietilen ose plastmasë, me qëllim që të pakësohet thithja e lagështirës së tepërt të ajrit.



3. Dritaret e magazinës ku mbahen plehrat, duhet të jenë të mbyllura dhe të hapen për ajrosje, vetëm në ditët me diell.

4. Plehrat që janë të ambalazuara në thasë, nuk duhet të vihen drejtpërdrejt në dysHEME në rastet kur ajo është e shtruar me beton.

5. Në të gjitha rastet, thasët e plehrave duhet të vendosen mbi paleta prej druri dhe numri i thasëve të vendosur njëri mbi tjetrin, të jetë jo më shumë se 8.

6. Në magazinat e ruajtjes së plehrave, në asnjë rast nuk duhet të mbahen kafshë, ushqime për njerëz dhe kafshë dhe produkte të mbrojtjes së bimëve. Gjithashtu, në këto magazina nuk duhet të mbahen elementet apo substancat e rrezikshme, të cilat mund të dëmtojnë zhvillimin e kulturave bujqësore apo të zinxhirit ushqimor.

7. Ambalazhet e rënda duhet të vendosen nën ambalazhet e tjera me peshë më të lehtë.

8. Subjektet prodhuese, në çdo kohë dhe për çdo kontingjent plehrash, marrin masa për mbrojtjen nga kushtet që shkaktojnë ndryshime dhe tjetërsimin e tyre.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Bujqësore dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Genc Ruli

UDHËZIM

Nr. 10, datë 13.9.2012

PËR MËNYRËN E PËRLLOGARITJES SË KRITEREVE TË VLERËSIMIT TË OFERTAVE PËR MARRJEN ME QIRA TË TOKËS BUJQËSORE, TË PANDARË

Në zbatim të nenit 102 të Kushtetutës dhe të udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore”,

UDHËZOJ:

1. Komisioni i dhënies me qira të tokës bujqësore të pandarë (KQTBP) zhvillon procedurën e garës, si dhe garantimin e barazisë për subjektet pjesëmarrëse, kur për të njëjtën tokë bujqësore është paraqitur më shumë se një kërkesë për qiramarrje.

2. KQTBP-ja i vlerëson ofertat e paraqitura, bazuar në kritere si më poshtë:

- teknologjia që do të aplikohet në kultivimin e bimëve, si dhe të përpunimit të produkteve;
- investimet kryesore mbi infrastrukturën (kullim, ujitje, sistemimin etj.), të shprehura në tregues fizikë dhe monetarë, si dhe investimet e lidhura me mbjelljen dhe kultivimin e bimëve, me përpunimin e produkteve etj.;

- ndikimin e investimit në rritjen e numrit të të punësuarve në komunën ose bashkinë përkatëse;

- propozimin për çmimin e ofruar për marrjen e tokës bujqësore me qira (lekë/ha në vit).

3. Në vlerësimin e kritereve të lartpërmendura, KQTBP-ja gjatë shqyrtimit të dokumentacionit përkatës për çdo ofertë të bërë, merr në konsideratë elementet e mëposhtme dhe i vlerëson ato me pikët e përcaktuara në vijim:

a) Teknologjia që do të aplikohet në kultivimin e bimëve, si dhe të përpunimit të produkteve:

- grup-kulturat e përcaktuara për mbjelljen e sipërfaqes së kërkuar për qiradhënie, sipas kërkesave të kreut IV të udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, me vlerësim si më poshtë referuar ndarjes të bërë në atë kre:

- për kulturat e përcaktuara në germën “a” 3 pikë;
 - për kulturat e përcaktuara në germën “b” 10 pikë;
 - për kulturat e përcaktuara në germën “c” 15 pikë;
 - kultura bujqësore të destinuar për prodhim bio 6 pikë;
 - zgjedhja e specieve dhe e kultivarëve për mbjellje të pemëve frutore, vreshtave dhe ullishtave në përshtatje me studimet zonale për tokat, objekt i qiradhënies 5 pikë;
 - teknikat dhe mënyrat e ujitjes:
 - ujitje me teknologji të avancuara (ujitje me pika, në formë shiu etj.) 10 pikë;
 - ujitje me metoda tradicionale (me brazda, me rrëshqitje etj.) 3 pikë.
 - b) Investimet kryesore mbi infrastrukturën (kullim, ujitje, sistemimin etj.), të shprehura në tregues fizikë dhe monetarë, si dhe investimet e lidhura me mbjelljen dhe kultivimin e bimëve, me përpunimin e produkteve etj.;
 - ndërtim dhe meremetim të rrjetit kullues dhe ujitës në kilometër 10 pikë;
 - sistemim sipërfaqësor të ngastrës në m² (*ose dynym*) 5 pikë;
 - ngritje punishte, impiante përpunimi ose fabrikë për përpunim të produkteve që merren nga toka, objekt i qiradhënies të shprehura në vlerë monetare 10 pikë.
 - c) Ndikimin e investimit në rritjen e numrit të të punësuarve në komunën ose bashkinë përkatëse;
 - numri i të punësuarve 4 pikë.
 - d) Propozimin për çmimin e ofruar për marrjen e tokës bujqësore me qira (lekë/ha në vit); çmimi i ofruar lekë/ha në vit 35 pikë.
4. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Genc Ruli

UDHËZIM
Nr. 2649/5, datë 4.7.2012

**PËR MBULIMIN E TË DËNUARVE ME BURGIM DHE TË PARABURGOSURVE NGA
SKEMA E SIGURIMEVE SHËNDETËSORE, TË DETYRUESHME**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 8 dhe 34 të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe pikat 2, 6 dhe 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 337, datë 6.4.2011 “Për përfshirjen e personave ekonomikisht joaktivë”,

UDHËZOJMË:

1. Identifikimi i kategorisë së personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosurve, si persona të siguruar në skemën e sigurimeve shëndetësore, bëhet kundrejt pajisjes me librezë shëndetësore.
2. Pajisja me librezë shëndetësore bëhet nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor (DRSKSH) e rajonit ku ndodhet qendra e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP), në bazë të listës emërore të të dënuarve dhe të paraburgosurve që ndodhen në institucion, të vërtetuara nga drejtori i institucionit.
Librezat e shëndetit të lëshuara nga DRSKSH-ja sipas listës përkatëse, i dorëzohen personit të autorizuar të IEVP-së penale, sipas projektudhëzimit të propozuar nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.
3. Afati i vlefshmërisë së librezës së shëndetit për personat e dënuar me burgim, llogaritet në bazë të kohës së mbetur të dënimit, të vërtetuar nga drejtori i IEVP-së, ndërsa për të paraburgosurit afati i vlefshmërisë është 3 muaj.



4. Personat e dënuar me burgim dhe të paraburgosurit pajisen me kartelë personale pranë mjekut që i ndjek në IEVP.

5. DRSKSH-të e rajonit në të cilin ndodhen IEVP-të, lidhin kontratë me drejtuesit dhe mjekët e IEVP-së për ofrimin e shërbimeve shëndetësore që mbulon skema e sigurimeve të kujdesit shëndetësor. Kontratat specifikohen në mënyrë të hollësishme në lidhje me rregullat për ofrimin e shërbimeve shëndetësore nga personeli mjekësor i IEVP-së, rregullat e kryerjes së vizitave, të plotësimit të dokumentacioneve dhe plotësimit të recetës së rimbursueshme.

6. Konsultat ambulatorie të specializuara, si dhe ekzaminimet laboratorike ose imazherike të të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve realizohen në institucionet shëndetësore të kontraktuara nga ISKSH-ja, sipas niveleve përkatëse, në zbatim të sistemit të referimit.

7. Trajtimi me barna të listës së barnave të rimbursueshme, realizohet në bazë të recetës me rimbursim të plotë, të plotësuar nga mjeku i institucionit në farmacinë e IEVP-së. Në recetat e rimbursuara plotësohen dhe rimbursohen 100% vetëm alternativat e para të listës së barnave të rimbursuara të miratuara me VKM.

8. Për furnizimin dhe rimbursimin e barnave të listës së barnave të rimbursuara, DRSKSH-ja dhe IEVP-ja lidhin kontratë trepalëshe me depon distributore të barnave të rajonit ku ato ushtrojnë aktivitetin. Nëse në atë rajon nuk ka depo distributor, kontrata lidhet me depon distributor të barnave të rajonit më të afërt.

9. Barnat e rimbursuara tërhiqen nga farmacisti i institucionit, sipas recetave të përshkruara nga mjeku në depo, kundrejt një listë-treguesi të miratuar nga drejtori i IEVP-së. DRSKSH-ja bën rimbursimin e depos kundrejt recetave dhe listë-treguesve përkatës.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

MINISTRI I SHËNDETËSISË
Petrit Vasili

UDHËZIM
Nr. 21, datë 24.9.2012

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR RUAJTJEN E SIGURISË SË TË DHËNAVE
PERSONALE TË PËRPUNUARA NGA KONTROLLUESIT E MËDHENJ**

Në mbështetje të shkronjës “f” pika 1 e nenit 31, dhe në bazë të detyrimeve të përcaktuara në nenin 27 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

UDHËZON:

1. Përcaktimin e masave teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e mëdhenj ose përpunuesit, më poshtë referuar subjektet përpunuese të të dhënave personale, si dhe rregullat e bashkëpunimit të tyre me Komisionerin.

2. Për qëllime të këtij udhëzimi, përkufizimet e mëposhtme kanë këto kuptime:

a) Kontrollues ose përpunues të mëdhenj janë subjektet përpunuese të të dhënave personale, të cilët përpunojnë të dhëna personale dhe sensitive në mënyrë elektronike ose manuale, duke shfrytëzuar 6 e më shumë persona për të kryer këtë përpunim, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me anë të përpunuesve;

b) Raportvlerësimi është raporti i rezultateve të kontrollit të fundit të sigurisë në sistemin e arkivimit;

c) Politika e sigurisë së informacionit (më poshtë referuar “PSI”) është dokumenti me anë të të

cilit subjekti përpunues i të dhënave i komunikon punonjësve të tij dhe kontraktorëve (përpunuesve) mënyrën e ndërtimit, zbatimit dhe operimit të sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit (më poshtë referuar “SMSI”) për mbrojtjen e të dhënave;

ç) Persona të ngarkuar janë të gjithë ata të cilëve subjekti përpunues i ka dhënë akses në të dhënat personale.

3. Kategoritë kryesore të përdoruesve, që detyrohen të ruajnë sigurinë e të dhënave personale, janë:

a) Administratorët e sistemeve të teknologjisë së informacionit, komunikimit (më tej të quajtur TIK) dhe të sigurisë së tyre, të cilët zbatojnë këtë detyrim kur subjekti, i cili përpunon të dhëna personale ka një sistem TIK të brendshëm dhe/ose të jashtëm të instaluar për të përmbushur këtë qëllim;

b) Operatorët e të dhënave personale (të punësuarit, të kontraktuarit etj.), të cilët përpunojnë të dhëna personale me qëllim, përmbushjen e detyrave të tyre kur punojnë për subjektin përpunues të të dhënave personale;

c) Të gjithë personat e caktuar nga subjekti përpunues për të përpunuar të dhënat në mënyrë manuale.

4. Përveç sa parashikohet në udhëzimin nr. 2, datë 25.2.2010 “Për detyrimet e kontrolluesve dhe përpunuesve përpara se të përpunojnë të dhënat personale”, subjektet përpunuese duhet të përpunojnë të dhënat personale në përputhje me rregullat e përcaktuara edhe në këtë udhëzim.

5. Dispozitat në lidhje me sigurinë e sistemit TIK janë të detyrueshme për ato subjekte që përpunojnë të dhëna personale në mënyrë elektronike. Për ato që përpunojnë të dhëna personale në mënyrë manuale, do të zbatohen vetëm dispozitat përkatëse për sigurinë fizike, sigurinë e ambientit dhe të personelit.

6. Komisioneri në çdo kohë mund t’i kërkojë subjektit përpunues të të dhënave personale të provojë nivelin dhe përmbajtjen e masave teknike, organizative dhe të sigurisë personale me anë të një raportvlerësimi. Raporti i vlerësimit duhet të jetë hartuar nga subjekti përpunues jo më tepër se dy vjet përpara kërkesës së Komisionerit. Subjektet përpunuese duhet të paraqesin, brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga dita e kërkesës, raportin e vlerësimit. Nëse vlerësimi nuk paraqitet në afat, Komisioneri i kërkon subjektit përpunues të të dhënave personale, që me shpenzimet e tij të kryejë një kontroll të ri dhe të dorëzojë raportin e vlerësimit brenda tre muajve.

7. Kontrolli i sigurisë së sistemit të përpunimit të të dhënave mund të kryhet vetëm nga një auditues i jashtëm (person fizik ose juridik) i pavarur e i paanshëm, si dhe profesionalisht i kualifikuar, i cili nuk ka marrë pjesë në zhvillimin, zbatimin dhe drejtimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit të sistemit të arkivimit.

KAPITULLI I

SISTEMI I MENAXHIMIT TË SIGURISË SË INFORMACIONIT (SMSI) PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE

8. Krijimi dhe mirëmbajtja e SMSI-së për mbrojtjen e të dhënave personale është i detyrueshëm për të gjitha subjektet përpunuese. Ky sistem bazohet në identifikimin, analizimin dhe në zbutjen e rreziqeve ndaj sigurisë së të dhënave personale duke marrë parasysh dobësitë e:

a) Sistemeve TIK të përdorura për përpunimin e të dhënave personale;

b) Të gjitha formave manuale të përpunimit të të dhënave personale;

c) Sigurisë fizike brenda dhe jashtë ambienteve, sigurisë së personelit dhe pajisjeve elektronike ose të lëvizshme.

9. Në rast se kontrolluesi përdor më shumë se një përpunues të madh, çdo përpunues duhet të ketë vënë në zbatim një SMSI. Ndarja e përgjegjësive për mbrojtjen e të dhënave personale ndërmjet palëve duhet të shprehet qartë në dokumentacionin që rregullon marrëdhëniet e tyre kontraktore. Të gjitha këto kërkesa do të përmbushen pa cenuar marrëdhënien kontraktore të delegimit (*outsourcing*). Kur kontrolluesi përdor një përpunues të vogël, atij do t’i komunikohen vetëm pjesët e zbatueshme për SMSI-në, të cilat do të jenë ligjërish të detyrueshme në një kontratë për përpunimin e të dhënave.



10. SMSI do të përcaktohet duke marrë parasysh standardet e sigurisë së informacionit, si më poshtë:

a) Konfidencialitetin, duke siguruar që të dhënat të jenë të aksesueshme vetëm për personat e autorizuar;

b) Integritetin, duke siguruar që të dhënat të jenë të sakta, të plota dhe duke ruajtur metodat e përpunimit të tyre;

c) Disponueshmërinë, duke siguruar aksesin e përdoruesit të autorizuar në të dhënat dhe në sistemet e përpunimit;

ç) Besueshmërinë e sistemeve TIK që janë përdorur për përpunimin e të dhënave dhe të personelit që i ka përdorur ato, duke garantuar që çdo aktivitet/veprim i tyre mbi të dhënat është i gjurmueshëm dhe i kontrollueshëm.

11. SMSI do të përfshijë, në veçanti:

a) Analizën e ndikimit në të dhënat personale (ADHP), parë nga këndvështrimi i subjekteve të të dhënave, të dhënat e të cilëve janë përpunuar. Përpara përpunimit të të dhënave personale, kontrolluesi ose përpunuesi duhet të kryejë një vlerësim të ndikimit të operacioneve të përpunimit që janë parashikuar në mbrojtjen e të dhënave personale, duke evidentuar se ku këto operacione përpunimi mund të paraqesin rreziqe të veçanta ndaj të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave për shkak të natyrës, shtrirjes ose qëllimit të tyre;

b) Politikën e sigurisë së informacionit, përfshirë sigurinë e përpunimit të të dhënave personale;

c) Kontrollin e sigurisë së sistemit të arkivimit të të dhënave personale;

ç) Udhëzime të detajuara të sigurisë që mbulojnë fushat specifike;

d) Sigurinë fizike brenda dhe jashtë ambienteve;

dh) Sigurinë e personelit dhe pajisjeve elektronike të lëvizshme ose jo.

12. SMSI duhet të funksionojë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, standardet teknike për sistemet e sigurisë së TIK-së, rregullat e praktikës së mirë në fushën e sigurisë së informacionit, dhe rekomandimet e hartuara nga organizata industriale profesionale, përfshirë bankat, telekomunikacionet, siguracionet, sigurimet shoqërore dhe kujdesin shëndetësor. SMSI duhet të jetë e përshtatur me nivelin e rreziqeve dhe dobësitë e sistemeve të përpunimit të të dhënave personale.

13. Në rast se përpunimi i të dhënave kryhet me anë të platformës “cloud computing” ose me anë të përpunimit të lëvizshëm, do të zbatohen masa sigurie shtesë (p.sh.: aktivizimi i shërbimit kundër vjedhjes në kompjuterin portabël ose në telefonin smart). Të gjitha pajisjet që shërbejnë si mbartës të dhënash do të kodohen.

14. Subjektet përpunuese përcaktojnë hapat që duhen ndërmarrë në rast incidentesh të shkeljes së sigurisë së të dhënave personale. Pas rezultatit të analizës së riskut, duhet të propozohet zbutja e duhur e rreziqeve në një nivel të pranueshëm. SMSI duhet të përfshijë edhe marrëveshjet specifike për vazhdimësinë e veprimtarisë tregtare (*business continuity plan*), për vendosjen e të cilave zbatohen standardet teknike dhe rekomandimet e vëna në dispozicion për publikun.

15. Dokumentacioni i SMSI-së mbahet nga personi i kontaktit për çështjet e mbrojtjes së të dhënave, i emëruar nga subjekti përpunues i të dhënave personale. Ky dokumentacion duhet të vihet në dispozicion të Komisionerit me kërkesën e tij brenda afatit të përcaktuar në kërkesë nga data e marrjes dijani.

KAPITULLI II POLITIKA E SIGURISË SË INFORMACIONIT

16. PSI duhet të hartohet dhe zbatohet përkatësisht nga subjekti përpunues i të dhënave personale.

17. PSI hartohet dhe mbahet në përputhje me rregullat e sigurisë së informacionit, siç përcaktohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe legjislacioni ndërkombëtar i ratifikuar, që rekomandohet nga standardet e përcaktuara të sigurisë, si dhe rekomandimet e Komisionerit. Analiza e riskut është pjesë përbërëse e PSI-së. Dokumenti i PSI-së specifikon qartë objektivat e sigurisë dhe

përcakton masat teknike dhe organizative të nevojshme për zbutjen e kërcënimeve dhe rreziqeve që prekin sistemet e arkivimit.

18. Në strukturimin e PSI-së, u kushtohet vëmendja e duhur standardeve teknike të sigurisë së informacionit, kodeve të praktikës së mirë, si dhe rekomandimeve e udhëzimeve të veçanta të miratuara nga Komisioneri. PSI-ja do të mbulojë aspektet e mëposhtme të sigurisë së informacionit të të dhënave personale:

a) Vlerësimin dhe trajtimin e riskut përmes kryerjes së analizës së riskut ndaj sigurisë së informacionit të subjektit përpunues;

b) Politikën e sigurisë, e cila nënkupton miratimin dhe zbatimin e dokumentit që vërteton mbështetjen dhe angazhimin që ka struktura drejtuese e subjektit ndaj sigurisë së informacionit;

c) Organizimin e sigurisë së informacionit nëpërmjet marrjes së masave për mbrojtjen e informacionit dhe sistemeve të tij nga aksesit i paautorizuar dhe nëpërmjet kryerjes së kontrolleve të sigurisë;

ç) Menaxhimin e asetëve duke përditësuar inventarin e të gjitha mjeteve të përpunimit dhe klasifikimin e kushteve të sigurisë për të përcaktuar se çfarë do të mbrohet, pse dhe si;

d) Sigurinë e burimeve njerëzore nëpërmjet marrjes së masave të sigurisë për punonjësit që rekrutohen, lëvizin dhe largohen nga subjekti përpunues;

dh) Sigurinë fizike dhe mjedisore nëpërmjet mbrojtjes së pajisjeve kompjuterike;

e) Menaxhimin e komunikimeve dhe operacioneve nëpërmjet kontrolleve të sigurisë teknike në sisteme dhe rrjete kompjuterike;

ë) Kontrollin e aksesit nëpërmjet kufizimit të të drejtave të aksesit në rrjet, sisteme, aplikime, funksione dhe të dhëna;

f) Blerjen, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të përpunimit të informacionit nëpërmjet ndërtimit të sigurisë në aplikacione;

g) Menaxhimin e shkeljeve të sigurisë së informacionit (referuar si incidente) nëpërmjet parashikimit dhe dhënies së kundërpërgjigjes ndaj shkeljeve të sigurisë së informacionit;

gj) Menaxhimin e vazhdimësisë së veprimtarisë tregtare nëpërmjet mbrojtjes, ruajtjes dhe rikuperimit të proceseve e sistemeve kritike;

h) Sigurimin e pajtueshmërisë me politikat e veçanta të sigurisë së informacionit, standardet, ligjet dhe rregulloret.

19. Gjatë zbatimit të dispozitave të këtij kapitulli, trajtohen në mënyrë të veçantë nga PSI-ja:

a) Përpunimi i të dhënave sensitive;

b) Menaxhimi i të drejtave të aksesit;

c) Rreziqet që vijnë nga aksesit në rrjetet publike, veçanërisht nga interneti.

20. PSI-ja specifikon objektivat bazë të sigurisë që duhet të arrihen për mbrojtjen e sistemit të arkivimit të të dhënave personale kundër shkeljes së sigurisë së saj dhe në veçanti ajo duhet:

a) Të përcaktojë objektiva të sigurisë bazë dhe masa për sigurinë minimale të kërkuar;

b) Të përcaktojë masa teknike, organizative dhe personale për sigurimin e të dhënave personale në sistemin e arkivimit dhe mënyrën e përdorimit të tyre;

c) Të bëjë përshkrimin e sistemit të arkivimit dhe lidhjen e tij me shkelje të mundshme të sigurisë;

ç) Të bëjë përkufizimin e kufijve që përcaktojnë rreziqet e mbetura.

21. Analiza e sigurisë së sistemit të arkivimit nënkupton një analizë të detajuar të gjendjes së sigurisë duke përfshirë, në veçanti:

a) Analizën e riskut në të cilën identifikohen kërcënimet që prekin pjesë individuale të sistemit të arkivimit, të afta të shkelin sigurinë apo funksionimin e tij; rezultati i analizës së riskut do të jetë një listë e kërcënimeve që mund të rrezikojnë konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave personale të përpunuara, ndërkohë që ajo do të deklarojë edhe shkallën e riskut të mundshëm, propozimet e masave për eliminimin apo minimizimin e ndikimit të riskut dhe një listë të rreziqeve të mbetura;

b) Përdorimin e standardeve të sigurisë dhe përcaktimin e metodave të tjera dhe mjeteve për mbrojtjen e të dhënave personale; vlerësimin e përshtatshmërisë së masave të sigurisë, të propozuara nga



standardet e sigurisë të aplikuara, metodat dhe mjetet do të përbëjnë një pjesë të analizës së sigurisë së sistemit të arkivimit;

c) Hartimin e rregulloreve të detajuara mbi sigurinë, të cilat do të specifikojnë dhe zbatojnë rezultatet që dalin nga SMSI sipas kushteve konkrete të sistemit të arkivimit të vënë në punë, të cilat do të përfshijnë, në veçanti:

i) përshkrimin e masave teknike, organizative të personelit, të përcaktuara në SMSI dhe përdorimin e tyre në kushtet konkrete;

ii) shtrirjen e kompetencave dhe përshkrimin e veprimtarive të lejuara të personave individualë që i gëzojnë ato të drejta, mënyrën e identifikimit të tyre dhe verifikimin gjatë aksesimit në sistemin e arkivimit;

iii) objektin e përgjegjësisë së personave të ngarkuar dhe të personit të kontaktit;

iv) mënyrën, formën dhe periodicitetin e kryerjes së aktiviteteve të inspektimit të fokusuar në vëzhgimin e sigurisë së sistemit të arkivimit;

v) procedurat gjatë avarive, dështimeve dhe situatave të tjera të jashtëzakonshme, duke përfshirë masat parandaluese për kufizimin e zhvillimit të situatave të jashtëzakonshme dhe mundësive për një restaurim efikas të gjendjes njësoj si përpara avarisë.

KAPITULLI III RASTE TË VEÇANTA TË PËRPUNIMIT

22. Për subjektet që përpunojnë të dhëna personale në mënyrë manuale, zbatohen dispozitat e mëposhtme:

a) Të gjitha dokumentet e përpunuara në mënyrë manuale ruhen të sigurta, në mënyrë që të parandalohet përhapja, shkatërrimi, humbja e paligjshme, si në vendin e punës ashtu edhe gjatë transferimit të tyre;

b) Vënia në dispozicion e kopjeve të kërkuara, mund të kryhet me kusht që të jetë i mundur gjurmimi i përdorimit të tyre të mëtejshëm deri në shkatërrimin ose anonimizimin e tyre;

c) Me mbarimin e periudhës së ruajtjes, dokumentet:

i) arkivohen, në rast se ekziston një detyrim i tillë ligjor; ose

ii) shkatërrohen fizikisht në mënyrë të pakthyeshme; ose

iii) bëhen anonime duke i kthyer të dhënat personale që ato mbajnë të palexueshme, në mënyrë të parevokueshme.

23. Për subjektet që përpunojnë të dhëna sensitive, si në mënyrë manuale ashtu edhe elektronike, rregullat shtesë të mëposhtme do të jenë të zbatueshme, përkatësisht për çdo mënyrë përpunimi:

a) Vëmendje e veçantë i kushtohet parandalimit të përhapjes së paligjshme:

i) në rast përpunimi manual, SMSI parashikon procedura shtesë specifike për trajtimin e dokumenteve shkresore me qëllim parandalimin e aksesit nga persona të paautorizuar në të dhënat personale që përmbajnë këto dokumente, gjatë gjithë ciklit jetësor të tyre;

ii) në rast transferimi elektronik të të dhënave personale, kanalet e transmetimit apo dokumentet që përmbajnë këto të dhëna do të kodohen, duke përdorur mënyra kodimi në përputhje me rezultatet e analizës së riskut të kryer më parë;

iii) në rast përdorimi të mjeteve elektronike portative si mbartës të informacionit, të dhënat do të kodohen përpara se të largohen nga mjediset e subjektit përpunues të të dhënave. Ky kodim këshillohet të kryhet, gjithashtu, edhe për të dhënat josenstitive.

KAPITULLI IV TRAJNIMI I PERSONELIT TË SUBJEKTIT PËRPUNUES TË TË DHËNAVE PERSONALE

24. Personeli i subjektit përpunues të të dhënave personale trajnohet rregullisht për mbrojtjen e të dhënave personale. Trajnimi kryhet sipas planit të përcaktuar më poshtë:

a) Personeli që përpunon të dhëna personale trajnohet të paktën një herë në vit;

b) Personeli, përveç përcaktimit në shkronjën “a”, trajnohet për të gjithë rastet e veçanta të listuara më poshtë:

- i) pas çdo ndryshimi thelbësor të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale;
- ii) pas çdo ndryshimi thelbësor të kuadrit ligjor europian për mbrojtjen e të dhënave personale, i cili paraprakisht publikohet në faqen zyrtare të Komisionerit;
- iii) pas ndryshimit të organizimit të SMSI-së, veçanërisht të PSI-së;
- iv) pas ndryshimit të procedurave të veçanta të sigurisë së përpunimit të të dhënave personale të subjektit përpunues.

Qëllimi i trajnimit dhe forma e organizimit të tij, duhet të zbatohen në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi.

25. Subjekti përpunues i të dhënave personale siguron trajnim profesional për personat e kontaktit të caktuar. Komisioneri mund t'i kërkojë subjektit përpunues të të dhënave personale të sigurojë prova për zhvillimin e trajnimit profesional.

KAPITULLI V

KONTROLLI I SIGURISË SË INFORMACIONIT TË SUBJEKTIT PËRPUNUES TË TË DHËNAVE PERSONALE

26. Kontrolli i sigurisë së informacionit (të të dhënave personale) nga subjektet përpunuese kryhet jo më pak se një herë në vit. Në subjektet përpunuese që mbështeten plotësisht në përpunimin elektronik të të dhënave për minimizimin e kostove, ky kontroll mund të jetë pjesë e kontrollit të përgjithshëm financiar vjetor, kur vlerësohet gjendja e veprimtarisë tregtare të subjektit. Komisioneri mund të kërkojë vënien në dispozicion të raporteve të kontrollit.

KAPITULLI VI

PERSONI I KONTAKTIT NË SUBJEKTET PËRPUNUESE

27. Subjekti përpunues i të dhënave personale është përgjegjës për mbikëqyrjen e brendshme të mbrojtjes së të dhënave personale të përpunuara. Çdo subjekt që i nënshtrohet këtij udhëzimi do të autorizojë me shkrim të paktën një person kontakti, për të kryer këtë mbikëqyrje. Subjekti përpunues do të njoftojë Komisionerin për autorizimin e vetëm një personi kontakti, edhe në rast se ai mund të emërojë disa për mbikëqyrjen e brendshme të mbrojtjes së të dhënave personale. Nëse subjekti zëvendëson personin e kontaktit, ai duhet të njoftojë Komisionerin jo më vonë se 14 ditë nga data e zëvendësimit.

28. Përpunuesi, objekt i këtij udhëzimi, emëron një ose më shumë persona kontakti, përgjegjës për garantimin e sigurisë së përshtatshme të të dhënave personale, kur vepron në emër të kontrolluesit. Përpunuesit e vegjël të kontraktuar nga subjekti përpunues që i nënshtrohet këtij udhëzimi, gjithashtu, këshillohet të emërojnë një person kontakti.

29. Personi kontakti mund të jetë çdo person që plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) Gëzon zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;
- b) Gëzon integritet;
- c) Ka arsim të lartë juridik ose shkenca kompjuterike;
- ç) Shquhet për aftësi profesionale dhe figurë të pastër etiko-morale;
- d) Ka eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet në profesionin e juristit ose të ekspertit të IT, ose ka punuar më shumë se 3 vjet në institucionin e KMDP-së me detyrën e juristit ose ekspertit IT;
- dh) Nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

Ai dorëzon vërtetim të gjendjes gjyqësore të përditësuar, e cila mbahet nga kontrolluesi gjatë kryerjes së funksionit të tij.

30. Përpara fillimit të përpunimit të të dhënave personale në sistemin e arkivimit, personi i kontaktit vlerëson riskun e shkeljes së të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave. Kjo analizë është pjesë përbërëse e analizës së ndikimit në të dhënat personale.

31. Personi i kontaktit, në kohën e duhur, njofton me shkrim subjektin përpunues të të dhënave



për çdo rrezik shkelje të të drejtave të subjekteve të të dhënave, përfshirë shkeljen e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

32. Në rast se pas njoftimit të personit të kontaktit, subjekti përpunues i të dhënave personale, dështon në marrjen e masave të duhura për trajtimin e problemit në kohën e duhur, personi i kontaktit njofton Komisionerin pa vonesë.

33. Brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të mbikëqyrjes së brendshme, subjekti përpunues i të dhënave personale që ka autorizuar personin e kontaktit do të njoftojë Komisionerin. Njoftimi duhet të përmbajë:

a) Emrin, adresën, numrin e identifikimit (NIPT-in) dhe/ose përfaqësuesit ligjorë të subjektit;
b) Gjeneralitetet e personit të kontaktit;
c) Pozicionin e personit të kontaktit brenda subjektit përpunues;
ç) Datën e emërimit me shkrim të personit të kontaktit;
d) Deklaratën e subjektit përpunues, ku përcaktohet se personi i kontaktit plotëson kushtet e parashikuara në pikën 29.

34. Personi i kontaktit ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) Është përgjegjës për mbikëqyrjen e brendshme, të përmbushjes së detyrimeve për mbrojtjen e të dhënave personale nga ana e subjektit përpunues të të dhënave personale;

b) Jep këshilla për personat përgjegjës;

c) Është përgjegjës për zbatimin e masave teknike, organizative, të personelit, si dhe mbikëqyr zbatimin e tyre në praktikë. Në veçanti, ai do të sigurojë dokumentacionin e SMSI-së që provon hartimin dhe mirëmbajtjen e duhur të saj;

ç) Në rast kontraktimi të një përpunuesi nga ana e subjektit përpunues të të dhënave personale, personi i kontaktit është përgjegjës për mbikëqyrjen e brendshme të veprimtarisë së përpunuesit, për përmbajtjen dhe hartimin e kontratës me shkrim për përpunuesin. Gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies kontraktuale apo autorizimit, personi i kontaktit do të verifikojë respektimin e kushteve të miratuara, duke përfshirë edhe angazhimin dhe ndryshimin e përpunuesve, në rast se ka;

d) Është përgjegjës për mbikëqyrjen e brendshme të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale;

dh) Është përgjegjës për dorëzimin e dokumentacionit të sistemeve të arkivimit për regjistrim të veçantë dhe shpalljen e ndryshimeve dhe çregjistrimin e sistemeve të arkivimit nga regjistri i veçantë. Ai mban të dhëna të sistemeve të arkivimit, që nuk janë subjekt regjistrimi dhe i vendos ato në dispozicion të kujtdo që ligjërisht ka të drejtë të ketë akses në to;

e) Është përgjegjës për bashkëpunimin e nevojshëm me Komisionerin në përmbushjen e detyrave brenda përgjegjësisë së tij;

ë) Me kërkesën e Komisionerit, ai është i detyruar t'i paraqesë autorizimin me shkrim mbi bazën e të cilit ai vepron, si dhe dëshmi për shkallën e njohurive të fituara në trajnime profesionale.

35. Pas caktimit të personit të kontaktit për mbikëqyrjen e brendshme të mbrojtjes së të dhënave personale, subjekti përpunues i të dhënave personale përjashtohet nga detyrimi për të paraqitur për regjistrim sistemet e arkivimit të të dhënave josensitive.

36. Personi i kontaktit siguron mbajtjen e rregullt të një inventari të sistemeve të arkivimit të të dhënave personale të përpunuara nga subjekti përpunues i të dhënave personale, përfshirë të dhënat personale të përjashtuara nga detyrimi për regjistrim në autoritetin e Komisionerit.

37. Aksesin në këtë inventar të sistemeve të arkivimit të të dhënave personale i ofrohet autoritetit të Komisionerit dhe subjekteve të të dhënave personale, të dhënat e të cilëve përpunohen në sistemin e veçantë të arkivimit mbi bazën e një kërkesë pa vonesë.

38. Subjekti përpunues i të dhënave personale është i detyruar t'i mundësojë personit të kontaktit të zbatojë mbikëqyrjen e brendshme të mbrojtjes së të dhënave personale në mënyrë të pavarur dhe të pranojë propozimet e ligjshme të tij. Njoftimi i mangësive ose bërja e një kërkesë nga personi i kontaktit në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të tij, nuk duhet të bëhet nxitje apo arsye për kryerjen e një veprimi nga ana e subjektit, që sjell dëme për të.

39. Komisioneri ka të drejtë t'i komunikojë dhe t'i kërkojë subjektit përpunues të të dhënave personale për të autorizuar një person tjetër kontakti për mbikëqyrjen e brendshme të mbrojtjes së të dhënave personale, me kusht që të jetë vërtetuar se ai, i cili fillimisht ka qenë i autorizuar, ka dështuar ose nuk ka përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimet e tij, ose ka vlerësuar gabimisht ose ka aplikuar gabimisht në praktikë të drejtat dhe detyrimet e subjektit të parashikuara nga ky akt, ose nuk përmbush kushtet profesionale apo etike.

40. Subjekti përpunues i të dhënave personale është i detyruar të përmbushë kërkesën e Komisionerit në kohën e duhur dhe të autorizojë, brenda 15 ditëve, një person tjetër për mbikëqyrjen e brendshme.

41. Nëse sa më sipër nuk është e mundur për arsye objektive, Komisioneri do të ofrojë një muaj shtesë për subjektin përpunues të të dhënave personale.

KAPITULLI VII RREGULLAT E PAJTUESHMËRISË

42. Rregullat e mëposhtme ndiqen për të garantuar pajtueshmërinë e duhur me këtë udhëzim:

a) Të miratohet përfaqja formale e analizës së riskut ndaj sigurisë së informacionit, bazuar mbi standardet e sigurisë së informacionit, në mënyrë që mbrojtja e të dhënave personale të jetë pjesë e pandarë e SMSI-së brenda subjektit përpunues;

b) Nëse subjekti përpunues ka vendosur të certifikojë pajtueshmërinë e tij me standardet teknike të sigurisë, ai duhet të vendosë në dispozicion të Komisionerit këtë certifikatë. Procesi i certifikimit për pajtueshmërinë me standardet e sigurisë së informacionit do të përfshijë edhe identifikimin, menaxhimin dhe zbutjen e dobësive dhe rreziqeve të sigurisë së të dhënave personale;

c) Shkeljet e rënda të sigurisë së të dhënave personale duhet të raportohen menjëherë te Komisioneri. Në rast se është emëruar personi i kontaktit, atëherë kjo është detyrë e tij.

43. Raportet e përditësuara të kontrollit mund të jenë plotësisht të pranueshme si një provë e pajtueshmërisë së subjektit përpunues me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, vetëm pasi hapat e mësipërm të jenë zbatuar dhe ai të ketë ruajtur certifikimet e pajtueshmërisë me standardet e sigurisë së informacionit që mbulojnë edhe përpunimin e të dhënave personale.

44. Përpara se të lidhë një marrëveshje kontraktore, që përfshin përpunimin e të dhënave personale, kontrolluesi ka detyrimin të kontrollojë përpunuesin për pajtueshmërinë e tij me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

45. Komisioneri, mbi këtë bazë, mund t'i kërkojë personit të kontaktit të kryejë një pjesë të procedurave të inspektimit, përfshirë kontrollin paraprak të dosjeve të të dhënave personale që përmbajnë të dhëna sensitive.

46. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen të gjithë kontrolluesit publikë e privatë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të përcaktuar në shkronjën "a" të pikës 2 të këtij udhëzimi.

47. Moszbatimi i kërkesave të këtij udhëzimi, përbën shkelje të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe dënohet sipas nenit 39 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, të ndryshuar.

Ky udhëzim hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI
Flora Çabej (Pogaçe)



UDHËZIM
Nr. 22, datë 24.9.2012

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR RUAJTJEN E SIGURISË TË TË DHËNAVE
PERSONALE TË PËRPUNUARA NGA KONTROLLUESIT E VEGJËL**

Mbështetur në shkronjën “f” të pikës 1 të nenit 31, si dhe në përputhje me detyrimet e përcaktuara në nenin 27 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;

UDHËZON:

1. Parashikimin e masave themelore teknike dhe organizative, për mbrojtjen e të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e vegjël të të dhënave ose përpunuesit, më poshtë referuar subjektet përpunuese të të dhënave personale dhe rregullat e bashkëpunimit të tyre me Komisionerin.

2. Kontrollues ose përpunues të vegjël konsiderohen të gjitha subjektet përpunuese të të dhënave personale, të cilët:

a) Përpunojnë të dhëna personale në mënyrë elektronike ose manuale, duke angazhuar më pak se 6 persona për kryerjen e tij, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me anë të përpunuesve;

b) Nuk përpunojnë të dhëna sensitive.

3. Kategoritë kryesore të përdoruesve, që detyrohen të ruajnë sigurinë e të dhënave personale, janë:

a) Administratorët e sistemeve të teknologjisë së informacionit, komunikimit (më tej të quajtur TIK) dhe të sigurisë së tyre, të cilët zbatojnë këtë detyrim kur subjekti, i cili përpunon të dhëna personale ka një sistem TIK të brendshëm dhe/ose të jashtëm të instaluar për këtë qëllim;

b) Operatorët e të dhënave personale (të punësuarit, të kontraktuarit etj.), të cilët përpunojnë të dhëna personale me qëllim, përmbushjen e detyrave të tyre kur punojnë për subjektin përpunues të të dhënave personale.

4. Përveç sa parashikohet në udhëzimin nr. 2, datë 25.2.2010 “Për detyrimet e kontrolluesve dhe përpunuesve përpara se të përpunojnë të dhënat personale”, subjektet përpunuese, duhet të përpunojnë të dhënat personale në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë udhëzim.

5. Subjektet përpunuese janë përgjegjës për sigurinë e të dhënave personale, duke i mbrojtur ato nga dëmtimet aksidentale apo të paligjshme ose shkatërrimi, humbja aksidentale, ndryshimi, aksesit i paautorizuar dhe vënia në dispozicion e personave të paautorizuar, si dhe kundër çdo forme tjetër të paautorizuar të përpunimit. Për këtë qëllim, ato duhet të marrin masat e duhura teknike dhe organizative, të përshtatshme për mënyrën e përpunimit dhe duhet të marrin në konsideratë mbi të gjitha:

a) Mjetet ekzistuese teknike;

b) Nivelin e rrezikut të mundshëm që mund të shkelë sigurinë ose funksionimin e sistemit të të dhënave personale.

6. Subjektet përpunuese duhet të vërtetojnë nivelin dhe përmbajtjen e masave teknike, organizative të marra sipas paragrafit 5.

7. Çdo subjekt përpunues mund të autorizojë, me shkrim, një person përgjegjës për mbikëqyrjen e sigurisë së të dhënave personale.

8. Standardet minimale për sigurinë e të dhënave personale duhet të përfshijnë:

a) Analizën e riskut

1. Analiza e riskut identifikon kërcënimet që prekin pjesë individuale të sistemit të arkivimit, të afta të shkelin sigurinë apo funksionimin e tij. Rezultati i analizës së riskut do të jetë një listë e kërcënimeve që mund të rrezikojnë konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave personale të përpunuara, ndërkohë që ajo do të deklarojë edhe shkallën e riskut të mundshëm, propozimet e masave për eliminimin apo minimizimin e ndikimit të riskut dhe një listë të rreziqeve të mbetura.

2. Analiza e riskut kryhet në mënyrë periodike, me qëllim identifikimin e rreziqeve kryesore ndaj të cilave sistemet janë të ekspozuara, si dhe dokumentimin e tyre në mënyrë të kuptueshme për praktikën e veprimtarisë së subjekteve përpunuese;

b) Sigurinë fizike dhe të ambientit

1. Sistemet e përpunimit të informacionit, programe ose pajisje TIK ku mbahet një *database* duhet të aksesohen me fjalëkalim. Gjithmonë të bëhet *backup*-i (një kopje sigurie) i të dhënave në një ambient tjetër të sigurt.

2. Të lejohet aksesimi fizik në pajisjet TIK për përpunimin e të dhënave personale, vetëm për personat e autorizuar dhe të mbahen regjistrime të identitetit të tyre.

3. Të shkatërrohen përfundimisht të gjitha pajisjet fizike që mbajnë të dhëna personale, kur ato e kanë përbushur qëllimin për të cilin ishin grumbulluar ose përpunuar dhe në veçanti, letrat e printuara, përfshirë fotokopjet, fotografitë dhe mbartës të tjerë të dhënash: CD ROM, DVD ROM, TAPE (kaseta regjistruese të *back up*), formularë, regjistra fizikë.

4. Në rastin e pajisjeve elektronike portative për ruajtjen e të dhënave, si dhe pajisjeve memorizuese të tjera, shkatërrimi duhet të bëhet në përmbajtje, në atë mënyrë që të mos jetë i mundur rigjenerimi i informacionit.

5. Të zbatohet politika për "*tavolinat e pastra*" në rastet kur kontraktohen ofrues të shërbimeve, të cilët lejohen të hyjnë në ambientet tuaja edhe në mungesën tuaj, siç janë: pastrimi i zyrës dhe mirëmbajtja e saj, siguria e ndërtesës, shërbimet teknike etj.

c) Sigurinë logjike të pajisjeve TIK të përpunimit të të dhënave personale

1. Nëse keni në zotërim pajisje TIK për përpunimin e të dhënave personale:

a. Të disponohen programe (*softëare*) të ligjshëm për përpunimin e të dhënave personale që mundësojnë përditësimet e sigurisë për përdoruesit e ligjshëm;

b. Të instalohen masa sigurie për:

- Garantimin e aksesit individual për t'i mundësuar çdo përdoruesi të punojë në llogarinë personale, duke përdorur mjete identifikimi si "emër përdoruesi" dhe "fjalëkalim";

- Kufizimin e mundësisë për të lidhur pajisje të jashtme vetëm në varësi të qëllimit që kërkohet, si dhe kontrollin e vazhdueshëm të tyre, duke bllokuar rrugë të tjera të aksesit.

c. Në rast përdorimi të një shërbimi të jashtëm, të kontraktuar për mirëmbajtjen e pajisjeve TIK të përpunimit të të dhënave personale:

- Punonjësi i palës së kontraktuar, i cili mund të ketë akses në të dhënat personale gjatë zbatimit të detyrave, të trajtohet si përpunuesi juaj;

- Të përfshihet siguria përkatëse e përpunimit të të dhënave në kontratën me këtë palë, duke i garantuar këtij të fundit, akses formal në të dhënat personale apo sistemet, të cilat mbartin të dhëna personale.

d. Në rast përdorimi të një shërbimi të jashtëm, duke marrë me qira pajisjet TIK për përpunimin e të dhënave personale, atëherë:

- Të përdoren komponentët e sigurisë që këshillohen nga ofruesi i shërbimit;

- Me mbarimin e kontratës së qirasë, të shkatërrohen të dhënat personale nga sistemet dhe pajisjet që do t'i kthehen pronarit të pajisjeve TIK, në atë mënyrë që të mos jetë e mundur që informacioni i mëparshëm të rigjenerohet.

2. Aksesimi në rrjetet publike

a. Nëse është e mundur, të kontraktohen ofrues të shërbimit të aksesit në internet që ofrojnë komponentë të sigurisë së rrjetit dhe të instalohen, nëse është e nevojshme, në pajisjet TIK që janë në përdorim;

b. Në rast marrje me qira të pajisjeve për përpunimin e të dhënave personale nga një palë e tretë e specializuar, të kontraktohet shërbimi që ofron komponentë të përditësuar të sigurisë së rrjetit;

c. Në rast përdorimi të lidhjes me internet pa kablo (*ëireless*), të mos përdoren pika aksesimi të pakoduara dhe të zbatohen standardet e sigurisë për lidhje të tilla.

c) Sigurinë e personelit

1) Të punësuarit duhet të informohen mbi rreziqet kryesore ndaj të cilave janë të ekspozuar.



2) Në rastet e punësimeve të reja, të zhvillohen trajnime në varësi të rrezikut të identifikuar dhe për të dhënat personale në lidhje me punësimin të ruhet konfidencialiteti.

3) Të udhëzohet personeli përkatës për ruajtjen e konfidencialitetit të të gjitha mënyrave të verifikimit, identifikimit që janë vënë në dispozicion, për aksesin në pajisjet TIK të disponueshme, që përdoren për përpunimin e të dhënave personale.

4) Të ndalohet aksesin menjëherë pasi punonjësit nuk i kërkohet më të përpunojë të dhënat personale.

9. Për subjektet që përpunojnë të dhëna personale në mënyrë manuale, zbatohen dispozitat e parashikuara në pikën 22 të kapitullit III të udhëzimit nr. 21, datë 10.9.2012 “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e mëdhenj”.

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen kontrolluesit publikë e privatë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të përcaktuar në pikën 2 të tij.

Moszbatimi i kërkesave të këtij udhëzimi, përbën shkelje të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe dënohet sipas nenit 39 të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Ky udhëzim hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI
Flora Çabej (Pogaçe)

VENDIM
Nr. 124, datë 24.9.2012

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION PRIVATE VENDORE “CAPITAL RADIO”
SUBJEKTIT: SHOQËRIA “CAPITAL RADIO” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, dhe rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “Capital Radio” sh.p.k., për t’u licencuar si operator radiofonik privat vendor dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. T’i japë shoqërisë “Capital Radio” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal rrethet Tiranë-Durrës.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen: struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr. 125, datë 24.9.2012

**PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION PRIVATE VENDORE “RADIO GLOB” SUBJEKTIT:
PERSON FIZIK EMILJANO HOXHAI**

Në mbështetje të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, dhe rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit person fizik Emiljano Hoxhaj, për t’u licencuar si operator radiofonik privat vendor dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit person fizik Emiljano Hoxhaj licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qytetin e Beratit.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen: struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr. 126, datë 24.9.2012

**PËR DHËNIE LICENCE SUBJEKTIT PERSON FIZIK ARDIAN SULOVARI PËR
TELEVIZIONIN PRIVAT KABLLOR “TV KABLLOR DIRE”**

Në mbështetje të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin nr. 221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit person fizik Ardian Sulovari për t’u licencuar si operator televiziv privat kabllor,

VENDOSI:

1. T’i japë licencë, subjektit person fizik Ardian Sulovari, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “TV kabllor DIRE”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qytetin e Kuçovës.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen: struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati



VENDIM
Nr. 127, datë 24.9.2012

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR
“TV ANTENA NORD”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat vendor “TV Antena Nord”, në fushën e transmetimeve televizive private vendore.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
Ky vendim i shtrin efektet nga data 15.1.2012 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr. 128, datë 24.9.2012

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR “RADIO
SCAN”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Scan”, në fushën e transmetimeve radiofonike private vendore.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
Ky vendim i shtrin efektet nga data 18.7.2012 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr. 134, datë 17.9.2012

**MBI KONTRATËN PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË
“KESH” SHA (FURNIZUESI PUBLIK ME SHUMICË) DHE SHOQËRISË “CEZ
SHPËRNDARJE” SHA (FURNIZUESIT PUBLIK ME PAKICË) PËR PERIUdhËN 1.1.2012
DERI MË 31.12.2014**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 dhe nenit 26 pika 1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 4.12 dhe 4.13 germa “A” pika 2 të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, i ndryshuar, pikës V.1 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë në mbledhjen e tij të datës 17.9.2011, pasi u njoh me propozimin e KESH sh.a. me nr. 1906 prot., datë 4.5.2012, si dhe relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s, mbi kontratën “Për furnizimin me energji elektrike ndërmjet shoqërisë “KESH” sh.a. (furnizuesi publik me shumicë) dhe shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. (furnizuesit publik me pakicë) për periudhën 1.1.2012 deri më 31.12.2014”,

konstatoi se:

Palët e kësaj kontrate KESH sh.a/FPSH dhe OSSH/FPP, janë të licencuara nga ERE përkatësisht:

- “CEZ Shpërndarje” sh.a. është e licencuar për aktivitetin e furnizuesit publik me pakicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 9, datë 25.1.2008, i ndryshuar;
- “KESH” sh.a. është e licencuar për aktivitetin e furnizuesit publik me shumicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 11, datë 23.6.2006, i ndryshuar.

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës për furnizim me energji elektrike ndërmjet shoqërisë “KESH” sh.a. (furnizuesi publik me shumicë) dhe shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. (furnizuesit publik me pakicë) për periudhën 1.1.2012 - 31.12.2014 me ndryshimet sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin e efektet nga data 1 janar 2012 deri në datën 31 dhjetor 2014.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

TEKSTI I NDRYSHIMEVE TË KONTRATËS

1. Në pikën 1 të nenit 3 të kontratës, fjalia e parë ndryshohet si vijon:

“Shitësi do të sigurojë energjinë elektrike në përputhje me sasinë e energjisë elektrike të planifikuar për efekt të përlogaritjes së tarifës së furnizuesit publik me shumicë për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014, në kohën dhe në sasinë siç do t’ia tregojë blerësi shitësit, sipas përcaktimeve të Modelit dhe Rregullave të Tregut.”.

2. Pika 8.3.i e kontratës, riformulohet:

“i- Në rastin e importit të një sasive më të madhe, “KESH” sh.a. do t’i kompensojë “CEZ Shpërndarje”, këtë diferencë pozitive me energji elektrike deri në fund të muajit m+2. Në rast se kompensimi nuk kryhet brenda periudhës m+2, “KESH” sh.a. është i detyruar të kompensojë “CEZ Shpërndarje” sh.a. në muajin m+3, me vlerën monetare që i korrespondon kostove reale të shkaktuara dhe të identifikuar nga “CEZ Shpërndarje” për sigurimin e kësaj sasive të energjisë elektrike.”.



3. Pika 8.3.ii e kontratës, riformulohet:

“ii- Në rastin e importit të një sasi më të vogël se humbjet reale në rrjetin e shpërndarjes, “CEZ Shpërndarje” do të kompensojë këtë sasi të energjisë elektrike të siguruar nga “KESH” sh.a., deri në fund të muajit m+2. Në rast se kompensimi nuk kryhet brenda periudhës m+2, “CEZ Shpërndarje” sh.a. është i detyruar të kompensojë “KESH” sh.a. në muajin m+3, me vlerën monetare që i korrespondon kostove reale të shkaktuara dhe të identifikuar nga “KESH” sh.a. për sigurimin e kësaj sasi të energjisë elektrike.”.

4. Pika 8.3.iii, shfuqizohet.

5. Neni 11 ndryshohet si vijon:

“Çmimi për livrimin e energjisë elektrike sipas kësaj kontrate do të jetë ai i aprovuar nga ERE sipas vendimeve përkatëse për përcaktimin e tarifës së furnizuesit publik me shumicë për periudhën e tretë rregullatore”.

6. Neni 15, pika 1, pas fjalëve “në favor të shitësit” të shtohen fjalët: “garancinë bankare në vlerën monetare që i korrespondon ½ së sasisë mesatare mujore të energjisë elektrike të planifikuar...”.

7. Neni 22 pika 1, ndryshohet si vijon:

“Kjo kontratë dhe secili nga kushtet këtu, do të hyjë në fuqi pas miratimit nga ERE dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2012 deri 31 dhjetor 2014”.

8. Në shtojcën 1 të kontratës, shtohet termi i mëposhtëm:

“Kosto reale – ka kuptimin e të gjitha shpenzimeve që identifikohen nga kompania për sigurimin e energjisë elektrike nga burimet përkatëse, përfshirë edhe të gjitha kostot shtesë të paparashikuara (*overdraft*), si dhe çdo vlerësim mbi impaktin e transaksionit në treguesit e efikasitetit të përdorimit të rezervave ujore”.

VENDIM

Nr. 135, datë 20.9.2012

MBI ANKIMIN ADMINISTRATIV TË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA NË LIDHJE ME VENDIMIN NR. 128, DATË 11.9.2012 “PËR PROCEDIMIN ADMINISTRATIV PËR VENDOSJE GJOBE NDAJ SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA” TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S

Në mbështetje të nenit 9 pikat 1, 4 dhe nenit 64, pika 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 26 pika 1 të ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, nenit 25 pika 1 të Kodit të Procedurave Administrative, nenit 328 të Kodit të Procedurës Civile, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.9.2012, pasi analizoi ankimin e paraqitur nga “CEZ Shpërndarje” sh.a. me shkresën nr. 5463/1, datë 18.9.2012, si dhe relacionin e përgatitur nga grupi i punës,

konstatoi se:

- Ligji nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 64 pika 4 përcakton se “*Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimit dhe ekzekutimi i vendimeve të Bordit bëhet sipas ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.*

- Ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” në nenin 26 të tij përcakton se “*Kundër vendimit për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënim me gjobë, të nxjerrë nga organi i administratës, mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit”.*

- Kodi i Procedurës Civile në nenin 328 të tij përcakton se “*Afati për paraqitjen e padisë ndaj një akti administrativ është tridhjetë ditë nga dita e shpalljes ose e njoftimit të vendimit të organit më të lartë administrativ, që ka shqyrtuar ankesën në rrugë administrative, përveç kur ligji parashikon ankimin e drejtpërdrejtë në gjykatë. Në këtë rast, afati fillon nga dita e shpalljes ose e njoftimit të aktit administrativ ndaj të cilit është paraqitur padia”.*

- Neni 25 i Kodit të Procedurave Administrative përcakton detyrimin e organeve administrative për të verifikuar, nëse kanë ose jo, juridiksionin për të vendosur mbi një çështje.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Deklarimin e mungesës së juridiksionit të ERE-s për ankimin e “CEZ Shpërndarje” “Mbi vendimin nr. 128, datë 11.9.2012 “Për procedimin administrativ për vendosje gjobe ndaj shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a.”;

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë “CEZ Shpërndarje” sh.a. për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 17.10.2012
Doli nga shtypi më 18.10.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 34 lekë